

# 5 VJET SPITALI AMERIKAN



**INTERVISTË ME DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË SPITALIT AMERIKAN DR. KLODIAN ALLAJBUE**



**K**ur daton themelimi i Spitalit Amerikan, si ju lindi kjo ide?

Ideja ime për hapjen e një spitali privat në Shqipëri ka nisur pothuaj 7 vite më parë, kur kam qenë student në Fakultetin e Mjekësisë në Ankara. Shihja e takoja me dhjetra pacientë shqiptarë që për të marrë trajtimin e duhur iu duhej të bënin jo vetëm një rrugë të gjatë. Ndaj Spitali Amerikan lindi nga nevoja për të përmbushur kërkesat e pacientëve. Kështu një ndërthurje mes idealizmit dhe nevojës u konkretizua në dhjetor 2006, para 5 vitesh, me hapjen e të parit institucion privat në vend.

**Në çfarë konsistonte puna e Spitalit Amerikan në 2006? Shumë prej nesh e njohën në ato kohë si spitali i zemrës, përse?**

E vërtetë, është ogur i mirë kur dikë nis nga zemra, apo jo. Investimi, përkujdesja dhe vëmendja e Spitalit Amerikan në 2006 u fokusua fillimisht në kardiologji dhe kardiokirurgji. Realizimi për herë të parë në vend i koronarografisë; revaskularizimi i arterieve koronare në gjendje akute të infarktut të miokardit ishte një prej arritjeve të ekipit të kardiokirurgëve. Pas sukseseve të tilla është e vështirë t'u dalësh nga zemra pacientëve dhe të mos mbahesh mend si spitali i zemrës.

**Kur u plotësua me të gjitha shërbimet dhe sa departamente numërohen sot?**

Spitali Amerikan në prag të vitit të parë të themelimit ofronte për pacientët shërbim në 16 departamente, ndërsa sot iu vjen në ndihmë me 24 departamente/urgjencë 24/7; 8 salla operacioni /130 shtretër/ 650 punonjës.

Përvjetori i 5-të i Spitalit Amerikan ka mbledhur në një mbrëmje Gala përfaqësues të qeverisë, politikës, fushës së mjekësisë, biznesit dhe trupit diplomatik të akredituar në Tiranë. Në fjalën e tij përshëndetëse ambasadori i USA z. Aleksandër Arvizu ka vlerësuar partneritetin e suksesshëm me Fondin Amerikan të Investimeve Bedminister Capital. Për Kryetarin e Bashkisë z. Lulzim Basha, arritjet e të parit institucion privat në vend janë tregues i zhvillimit dhe standarteve ndërkombëtarë që tashmë janë prezente nën emrin dhe logon e Spitalit Amerikan.



**Të tjerë spitale janë hapur disa vite pas jush, por me sa duket për shumë pacientë vendin e Spitalit Amerikan nuk e ze asnjë. Çfarë ju bën të veçantë? Çfarë ka armë të fortë Spitali Amerikan?**

Stafi i Spitalit Amerikan është në punë të vazhdueshme në kërkim të perfeksionit. Janë pikërisht profesionalizmi i stafit dhe teknologjia e standarteve më të larta dy nga armët tona më të forta që bëjnë diferencën. Për ne, pacienti nuk është vetëm dhimbje, plagë, infeksion, rezultat negativ i një analize, por një qenie njerëzore, për të cilin

ne jemi aty-afër tij për t'i larguar ankthin, trishtimin, dhimbjen dhe për t'i rikthyer shëndetin dhe shpresën. **Sot numëroni 4 spitale, ku janë të lokalizuara dhe çfarë ofron secillit?**

Pas Spitalit Amerikan në Laprakë, në Maj 2009 Grupi i Spitaleve Amerikane u zgjerua me American Medical Center Fier dhe më tej, në shkurt 2010 me American Medical Center Durrës. Dy qendrat mjekësore në dy qytetet e mëdha të vendit, jo vetëm shërbejnë si qendra referente në diagnostikë e imazheri, por edhe kanë lehtësuar ndjeshëm barrën e pacientëve të hemodializës,

të cilët e marrin tashmë këtë shërbim më pranë vendeve ku banojnë.

**Krijta e vazhdueshme e grupit të Spitaleve Amerikane kulmoi në Mars 2011 me hapjen e Spitalit të dytë në Tiranë. I certifikuar për menaxhimin e cilësisë që në hapat e tij të parë, Spitali Amerikan 2 është kryesisht i fokusuar në lindje, pediatri, neonatologji, kirurgji gjinekologjike,**

**ortopedi, urologji dhe kirurgji plastike. Një nga armët e forta është Qendra e Shëndetit Riprodhues dhe Fertilizimit In Vitro me Laboratorin e parë dhe të vetëm të Andrologji - Embri-**

**ologjisë, me të tilla përmasa dhe të tillë mbështetje teknologjike moderne në Shqipëri.**

**A mund të drejtohet çdokush për çfarëdo problemi që ka në Spitalin Amerikan? Mund të themi që çdo shërbim është i mbuluar? Po urgjenca?**

Po e nis nga pyetja e fundit, ashtu si në çdo protokoll mjekësor urgjencat marrin prioritet. Në dy spitale të Tiranës urgjenca është 24/7, pra të 24 departamentet ofrojnë shërbimin e tyre të shtirirë në 24 orë. Urgjenca ka pritur dhe trajtuar mijëra pacientë që sot e njohin Spitalin Amerikan si

derën e duhur për të trokitur për urgjencat kardiake, pediatrike, ortopedike.

**Ka ndonjë episod apo arritje të veçantë të këtyre 5 viteve që do ta veçonin nga të tjerët?**

Spitali Amerikan në këto 5 vite aktivitet ka treguar se është pararojë e zhvillimit në mjekësinë shqiptare. Prej vitit 2010, për shërbimin dhe kontributin e dhënë deri më tani, Spitali Amerikan është anëtar me të drejta të plota në American Hospital Association. Numri i madh i pacientëve, besimi dhe shpresa që është krijuar ndër ta, flet shumë për ne. Kirurgjia e zemrës dhe aortës, transplanti i veshkës; transplanti i kornesë; kirurgjia e vito retinës; implanti koklear; fertilizimi in vitro janë disa prej arritjeve që do të veçoja. Sigurisht, e gjitha kjo falë bashkëpunimit dhe partneritetit të suksesshëm me Fondin Amerikan të Investimeve Bedminister Capital.

**Po ndonjë moment veçanërisht të vështirë, apo që ju ka sfiduar gjatë kësaj kohe?**

Çdo gjë në mjekësi është sfidë, pasi është një terren i vështirë. Nuk është e lehtë të operosh në sistemin shëndetësor, për vetë specifikën e fushës.

**Mesa duket nga rrugëtimi që rrëfeni, SA është gjithnjë në rritje dhe në kërkim të sfidave të reja. Çfarë ka në rradhe?**

Të jesh lider dhe të vendosësh standartet në rang kombëtar dhe jo vetëm, për ne do të thotë të kesh zgjidhje për çdo kërkesë të çdo pacienti, t'u ofrosh atyre sistemin më eficient dhe teknologjinë më të lartë në mbështetje të profesionalizmit të stafit. Do të thotë të jesh gjithmonë disa hapa para e të mos ndalesh asnjë ditë së përmirësuarit dhe avancuarit nëpërmjet punës kërkimore dhe edukimit. Pasi u kemi shërbyer në distancë mijëra pacientëve kosovarë ka ardhur koha të jemi të pranishëm në Kosovë. Ky është hapi ynë i rradhës në muajt e parë të 2012.

**Sot numëroni 115 mijë pacientë, një fjalë të fundit për të gjithë ata që kanë qenë pacientë.**

Unë dëshiroj t'u drejtohem me urimin e rradhës, do të parapëlqejja urimet dhe mirënjohjen se sa fjalët e fundit...Duke përfutur nga festa e fundvitit uroj për të gjithë shqiptarët, dhe jo vetëm për ata që kanë qenë pacientë të Spitalit Amerikan, shëndet dhe suksese.

